



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:155277

Datë: 25.02.2025

Numri i dokumentit: 06901187

P.nr.474/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares Blerinda Lajq, në çështjen penale ndaj të pandehurit I.D, nga Peja, për shkak të veprës penale “*Shpërdorimi i pasurisë së huaj*” nga neni 318 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nën shenjë PP/II.nr.786/2024 e datës 28.05.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 25.02.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Agim Kurmehaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të dëmtuarit T.H, si dhe të pandehurit I.D, me datën 25.02.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.02.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I.D, i lindur më, në Pejë, ku edhe tani banon në rr. “.....” nr. ..., nga babai M. dhe nëna K., e gjinisë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, posedon numër telefoni, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit, Boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

Në bazë të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPRK-së.

REFUZOHET AKUZA

Për shkak se:

Me dt., rreth orës, në Pejë, rr. “.....”, pikërisht në barnatoren A. Pharm, me qëllim që vetes të i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit tjetër, tek posedimi i së cilës ka ardhur rastësisht, në atë mënyrë që i pandehuri i cili kishte shkuar në barnatore për ilaqe, ja ka marrë portofolin me të holla në shumën rreth 45 euro, dokumente personale të shtetit të Suedisë të cilën paraprakisht e kishte harruar i dëmtuari T.H deri sa kishte qenë në barnatore, për të blerë ilaqe për nevoja personale dhe pasi është identifikuar nga kamerat e sigurisë dhe është njoftuar nga punëtorët e barnatores i pandehuri portofolin pas dy ditëve ia kthen të dëmtuarit,

-Me çka kishte për të kryer veprën penale **“Shpërdorimi i pasurisë së huaj”** nga neni 318 par.5 e lidhur me par. 1 të KPK-së.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë, me datën 28.05.2024 ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/II.nr. 786/2024, ndaj të pandehurit I.D, për shkak të veprës penale **“Shpërdorimi”** nga neni 318 par.5 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën gjyqësore me dt. 25.02.2025, në të cilën seancë kanë qenë prezent Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, Agim Kurmehaj, i dëmtuari T.H, si dhe i pandehuri I.D.

Fillimisht, gjykata në pajtim me nenin 241 par.1 të KPPRK-së e ka udhëzuar të pandehurin I.D, për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit, ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se gjatë përpilimit të aktakuzës ka ndodhur një gabim teknik, ku tek kualifikimi i veprës penale duhet të jetë **“Shpërdorimi i pasurisë së huaj”** neni 318 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, e jo **“Shpërdorimi”** siç ndodhej në dispozitivin e aktakuzës.

Pas leximit të aktakuzës, dhe deklarimit të të pandehurit se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shitesë, para deklarimit të të pandehurit lidhur me pranimin ose mospranimin e fajësisë, i njëjti fillimisht është njoftuar me pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë.

Ndërkaq, duke pasur parasysh rikualifikimin e veprës penale të bërë nga Prokurori i Shtetit dhe pasi që ndjekja penale për veprën penale **“Shpërdorim i pasurisë së huaj”** nga neni 318 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe faktit se i dëmtuari i pyetur nëse qëndron pas ndjekjes penale për këtë çështje penale, i njëjti ka deklaruar se: *“Unë prej ditës që ka ndodhur rasti, i kam treguar edhe zyrtarëve policor që nuk dëshirojë që të ndjeket penalisht i pandehuri I. dhe nuk jap pëlqimin që i njëjti të ndjeket, duke shtuar se i njëjti është në gjendje të dobët ekonomike dhe dëshiroj që i njëjti të vazhdojë me hallet e veta.*

Tutje, Prokurori i Shtetit, ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se: *duke marrë parasysh këtë gjendje faktike, dhe pasi që e bëra edhe kualifikimin e drejtë të veprës penale si në aktakuzë, dhe duke u nisur nga fakti se i dëmtuari në seancën e sotme, nuk është i interesuar dhe nuk ka jep pëlqimin*

as në fazën paraprake për ndjekjen e kësaj vepre penale, meqenëse me Kodin Penal të Kosovës, neni 318 par. 7 që parasheh se këto vepra penale ndiqen vetëm sipas propozimit të palës së dëmtuar, unë heq dorë nga ndjekja penale si dhe aktakuza.

Meqenëse prokurori i shtetit ka hequr dorë nga aktakuza nën shenjën PP/II.nr.786/2024 të datës 28.05.2024, ndaj të pandehurit I.D, nga Peja, për shkak të veprës penale “Shpërdorim i pasurisë së huaj” nga neni 318 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke pas parasysh dispozitën e nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së, e cila përcakton se: “1. Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur: 1.1 prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor”, andaj shtuar këtu faktin se tërheqja e aktakuzës eliminon bazën juridike për vazhdim të gjyqimit, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Konform nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

Andaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.474/24, me datë 25.02.2025.

Zyrtare ligjore

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Blerinda Lajq

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.